

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ERSEKA SOLAR PARK 2” SHPK

Kreu I

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA

Data e Themelimit, Emri dhe themeluesit

Sot, më datë 12/12/2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ERSEKA SOLAR PARK 2” SHPK. Ky statut hartohet në bazë të parashikimeve të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.

Themeluesit e shoqërisë janë:

- 1. Shoqëria “FAVINA” sh.p.k, person juridik me NIPT: J64104078V** me seli në Korçë Lagjia 18 Rruga “Anastas Lakçe” me objekt veprimtarie prodhim dhe tregtim të energjisë elektrike nga burime diellore, Fotovoltaike, ndërtim, prodhim materiale ndërtim, Studio Projektimi etj përfaqësuar nga dy administratorët Viktor Qylafi, datëlindja 03.02.1963, posedues i letërnjoftimit me Nr.personal: G3020319R madhor, me zotësi të plotë juridike, dhe Administratori Adnan Qylafi, datëlindja 01.06.1966, posedues i letërnjoftimit me Nr.personal: G60601040R madhor, me zotësi të plotë juridike.
- 2. Shoqëria “FAVINA. 1” sh.p.k, person juridik me NIPT: K54624001I** me seli në Vithkuq, Hidrocentrali Vithkuq Prodhim dhe objekte veprimtarie: Tregëtim të Energjisë Elektrike, përfaqësuar nga dy administratorët Viktor Qylafi, datëlindja 03.02.1963, posedues i letërnjoftimit me Nr.personal: G3020319R madhor, me zotësi të plotë juridike, dhe Administratori Adnan Qylafi, datëlindja 01.06.1966, posedues i letërnjoftimit me Nr.personal: G60601040R madhor, me zotësi të plotë juridike.
- 3. Shoqëria “M&K ENERGY TRADING CO” sh.p.k, person juridik me NIPT: M04516001I** me seli në Korçë: Kompleksi Favina, Godina Nr.5, Lagjia 18 Rruga “Anastas Lakçe”, me objekt veprimtarie Prodhim i energjisë elektrike nga hidrocentralet, parqet fotovoltaike, parqet eolike, blerje dhe shitje me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike nga njësitë e prodhimit të subjekteve të licensuar tek konsumatorët, etj përfaqësuar nga Administratori Fatmir Qylafi, datëlindja 12.09.1995, posedues i letërnjoftimit me nr.personal: J50912034Q, madhor, me zotësi të plotë juridike.

Neni 2 **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj :

- Ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "Erseka Solar Park 2" dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 20 MW(AC), në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës.
- Prodhim, transmetim dhe shitje të energjisë elektrike të prodhuar nga centrali gjenerues "ERSEKA SOLAR PARK 2".
- Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e centralit "ERSEKA SOLAR PARK 2" gjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë tregtare të shoqërisë.

Neni 3 **Forma Ligjore**

3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar të Republikës së Shqipërisë.

3.2 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

Neni 4 **Baza ligjore**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, te ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar te fushes ne fuqi.

Neni 5 **Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

Shoqëria "ERSEKA SOLAR PARK 2" sh.p.k. e kryen veprimtarinë e saj tregtare për një periudhë kohore të pacaktuar derisa të vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme.

Shoqëria fiton personalitetin juridik në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe nga kjo datë ajo mund të fillojë të ushtrojë aktivitetin tregtar deri kur me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme të vendoset prishja e shoqërisë ose kur shoqëria mbaron në një nga mënyrat e parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6 **Selia**

6.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Nr. pasurie 3/1149-N2 Kompleksi Favina, Rr. Anastas Lakce, Korce, Shqiperi 7001.

Neni 7
Vula e shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e saj duke shënuar në të emrin e shoqërisë ose iniciale ESP 2.

Kreu II

KAPITALI, KALIMI DHE FITIMI I KUOTAVE

Neni 8

Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 1,000,000 (nje milion) Lekë.

8.2 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 3 kuota:

8.3 Kuotat do të zotërohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

a. Shoqëria "FAVINA" sh.p.k. zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 240,000 Lekë, që përbën 24% të kapitalit të Shoqërisë,

b. Shoqëria "FAVINA.1" sh.p.k. zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 240,000 Lekë, që përbën 24% të kapitalit të Shoqërisë,

c. Shoqëria "M&K ENERGY TRADING CO" sh.p.k. zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 520,000 Lekë, që përbën 52% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi i kapitalit

9.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ne perputhje me parashikimet e ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare. Nese vendimi per zmadhimin e kapitalit nuk eshte unanim ne shoqerite Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k per shkak te pjesemarrjes 50% me 50% te ortakeve dhe te drejtes se votimit po ne kete pjesemarrje (50% me 50%), nuk mund te zmadhohet kapitali i shoqerise Erseka Solar Park 2. Ky vendim duhet te merret njehere brenda shoqerive Favina dhe Favina 1 sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co dhe te miratohen ne menyre unanime nga ortakët e Shoqerive Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k ne menyre qe te kalohet me vendim nga Asambleja e Shoqerise "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimi i Shoqerive "Favina" sh.p.k, "Favina 1" sh.p.k dhe "M&K Energy Trading Co" sh.p.k administrohet ne kete vendim te shoqerise "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimet e Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co sh.p.k jane pjese e praktikës dokumentare qe mbahen ne disa kopje.

9.2 Nese vendimi i Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k per zmadhimin e kapitalit nuk eshte unanim dhe merret nje vendim ne shoqerine "Erseka Solar Park 2" sh.p.k prej nje ortaku te Favina 1 sh.p.k dhe Favina sh.p.k se bashku me ortakun M&K Energy Trading Co sh.p.k,

ky vendim eshte i pavlefshem. Pavlefshmeria eshte automatike, sepse nuk ka administruar vullnetin unanim te te dy ortakeve te shoqerive perberese te quajtur Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k. Pra nese nuk bie dakort Asambleja e Ortakeve te shoqerive Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k, per te zmadhuar kapitalin, atehere ky zmadhim nuk mund te kryhet edhe te shoqeria Erseka Solar Park 2.

9.3 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributëve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

9.4 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Do t'u ofrohen për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë.

9.5 Nëse kuotat e reja do t'u ofrohen për nënshkrim një palë të tretë, jashte Shoqërisë, atëherë duhet miratimi me Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Nese vendimi nuk eshte unanim tek Favina dhe Favina 1 sh.p.k per shkak te pjesemarrjes 50% me 50% te ortakeve dhe te drejtes se votimit po ne kete pjesmarrje (50% me 50%) pala e trete nuk mund te ofrohet per nenshkrim. Keto vendime duhet te merren njehere brenda shoqerive Favina sh.p.k dhe Favina.1 sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co dhe te miratohen unanimisht nga ortaket e shoqerive ne shoqerite Favina sh.p.k dhe Favina.1 sh.p.k ne menyre qe te kalohet ne vendim te shoqerise aktuale "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimi i Asamblese se Ortakeve te marre prej shoqerive Favina sh.p.k dhe Favina.1 sh.p.k administrohet ne kete vendim shoqerie "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimet e Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k jane pjese e praktikës dokumentare qe mbahen ne disa kopje.

9.6 Nese vendimi i Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k per transferimin e kuotave nuk eshte unanim dhe merret nje vendim ne shoqerine "Erseka Solar Park 2" sh.p.k prej nje ortaku te Favina 1 sh.p.k dhe Favina sh.p.k se bashku me ortakun M&K Energy Trading Co sh.p.k, ky vendim eshte i pavlefshem. Pavlefshmeria eshte automatike, sepse nuk ka administruar vullnetin unanim te te dy ortakeve te shoqerive perberese te quajtur Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k. Pra nese nuk bie dakort Asambleja e Ortakeve te shoqerive Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k, per te transferuar kuotat e reja, atehere ky transferim nuk mund te kryhet edhe te shoqeria Erseka Solar Park 2.

9.7 Vendimet e Favina sh.p.k dhe Favina. 1 sh.p.k i bashkangjiten vendimeve te "Erseka Solar Park 2" dhe kjo eshte pjese e praktikës dokumentare. Gjithashtu dhe vendimet e M&K Energy Trading Co sh.p.k i bashkangjiten vendimeve te "Erseka Solar Park 2" dhe kjo eshte pjese e praktikës dokumentare.

9.8 Shoqeria mund te rrise kapitalin e saj themelor gjate aktivitetit te saj. Shtimi ose pakesimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se Ortakeve. Kufiri i pakesimit te kapitalit themelor eshte ne perputhje me nenin 70 te Ligjit Nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ne lidhje me minimumin e mundeshem te tij.

9.9 Në rastin kur një ortak kundërshton parashikimin e mësipërm, atëherë Asambleja e Ortakëve do të procedojë me zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve të Ligjit, ndërkohë që ortakut që nuk merr pjesë në financim i zbritet përqindja që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë në proporcionalitet me investimin që kryhet nga ortaku(et) tjetër, duke u rritur proporcionalisht përqindja e kuotes ortakut/ortakeve investues në raport me investimin. Procedura e investimit, vleresimit, dhe pasqyrimit në kuote në raport me kapitalin kryhet nga ekspert kontabel.

Neni 10 Zvogëlimi i Kapitalit

10.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Ortakëve, e cila merr vendim në përputhje me parashikimet e ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Nëse vendimi për zvogëlimin e kapitalit nuk është unanim në shoqëritë Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k për shkak të pjesëmarrjes 50% me 50% të ortakeve dhe të drejtës së votimit po në këto pjesëmarrje (50% me 50%), nuk mund të zvogëlohet kapitali. Ky vendim duhet të merret njëherë brenda shoqërive Favina dhe Favina 1 sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co dhe të miratohen në mënyrë unanime nga ortakët e Shoqërive Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k në mënyrë që të kalohet me vendim nga Asambleja e Shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimi i Shoqërive "Favina" sh.p.k, "Favina 1" sh.p.k dhe "M&K Energy Trading Co" sh.p.k administrohet në këto vendime të shoqërisë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k. Vendimet e Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co sh.p.k janë pjesë e praktikës dokumentare që mbahen në disa kopje.

10.2 Nëse vendimi i Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k për zvogëlimin e kapitalit nuk është unanim dhe merret një vendim në shoqërinë "Erseka Solar Park 2" sh.p.k prej një ortaku të Favina 1 sh.p.k dhe Favina sh.p.k së bashku me ortakun M&K Energy Trading Co sh.p.k, ky vendim është i pavlefshëm. Pavlefshmëria është automatike, sepse nuk ka administruar vullnetin unanim të të dy ortakeve të shoqërive perberese të quajtur Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k. Pra nëse nuk bie dakort Asambleja e Ortakeve të shoqërive Favina sh.p.k dhe Favina 1 sh.p.k, për të zvogëluar kapitalin, atëherë ky zvogëlim nuk mund të kryhet edhe të shoqëria Erseka Solar Park 2.

10.3 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

10.4 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

Neni 11 Transferimi i Kapitalit, Kufizimet mbi Transferimin

11.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj

11.2 Ortaku qe kerkon te shese plotesisht apo pjeserisht kuotat zoteruese te kapitalit ne shoqeria Erseka Solar Park 2 sh.p.k ne rradhe te pare iu drejtohet shkreserisht, me leter rekomande duke vene ne dijeni dhe shoqerine Erseka Solar Park 2 sh.p.k, secilit prej ortakeve te tjere ekzistues te shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k me ane te se ciles iu ofron per blerje ketyre ortakeve kuotat zoteruese qe kerkon te shese.

11.3 Ortaket ekzistues te shoqerise ERSEKA SOLAR PARK 2 sh.p.k brenda 7 (shtate) diteve kalendarike nga marja e shkreses se derguar nga ortaku qe ofron per shitje kuotat kane detyrimin ti kthejne pergjigje shkreserisht me leter rekomande ortakut ofrues nese pranojne ose nuk pranojne te blejne kuotat e ofruara per blerje. Ne rast mos kthimi pergjigje shkreserisht, me leter rekomande brenda 7 (shtate) diteve kalendarike nga marja e shkreses qofte nga njeri apo nga secili prej ortakeve te tjere ekzistues te shoqerise ERSEKA SOLAR PARK 2 sh.p.k, nga e nesermja e dites se 7-te ortaku qe kerkon te shese kuotat eshte i lire t'ia shese ato çdo personi te trete jo ortak qe ai do ta shikoje te arsyeshme, qofte ky individ, person fizik ose person juridik. Cmimi i shitjes se kuotave kundrejt personave te trete jo ortake, jashte shoqerise ne asnje rast nuk do te jete me i ulet se cmimi qe iu eshte ofruar ortakeve ekzistues brenda shoqerise.

11.4 Ortaket bien dakord qe transferimi i kuotave, si veprim juridik ndermjet te gjalleve, te behet me akt noterial, ne rast te kundert eshte i pavlefshem. Kalimi i kuotave ne favor te ortakeve te tjere te shoqerise ose tek te tretet te bëhet me anë të një kontrate noteriale me shkrim. . Ky statut perjashtion rastin me shkrese te thjeshte te transferimit te kuotave si veprim juridik ndermjet te gjalleve, midis personave juridike ose/ dhe fizike, duke percaktuar transferimin vetem me akt noterial te redaktuar nga noteri dhe te regjistruar ne sistemin noterial. Kuotat mund te disponohen me testament nga titullari i tyre.

11.5 Kushtet e percaktuara ketu me lart ne pika 11.4 e ketij Statuti jane ne perputhje me nenin 73 te Ligjit Nr.9901 Date, 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", të ndryshuar.

Kreu III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 12 Asambleja e Ortakëve

12.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

12.2 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve ("Asambleja e Ortakëve"), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruara nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakeve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.

Vetëm Asambleja e Ortakeve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme me shumice të thjeshte mbi 50% :

- të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
- emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- të miratojë raportet vjetore dhe bilancet
- të vendosë pagën e Administratorit;
- të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- të vendosë mbi organizimin administrativ të Shoqërisë;
- të vendosë mbi buxhetin vjetor përveç shpërndarjes së fitimit;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti. dhe çështje që kanë lidhje me organizimin, planifikimin dhe strategjinë e shoqërisë afatgjate dhe afatshkurter

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

Vendimet e listuara më poshtë :

- në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti,
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit,
- të themelojë dhe/ose të mbyllë degë dhe perfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë
- shpërndarjen e fitimit,
- marrjen e kredive, nga institucione financiare
- marrja e huave nga institucione financiare
- dhënie të garancive nga Shoqëria,

- organizimin dhe prishjen e shoqërisë

kërkojnë një shumicë të cilësuar prej 80% të totalit të votave të ortakëve të Shoqërisë. Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të zakonshme të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të dispozitave të përcaktuara në ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare përveç se kur thuhet ndryshe në këtë statut.

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve dhe Rendi i Dites

14.1 Rendi i ditës, që njoftohet se cili do të jetë paraprakisht dhe duhet të përmbajë edhe vendimet e propozuara për çdo çështje.

14.2 Nëse asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet të njoftohet së bashku me rendin e ditës.

14.3 Administratorët duhet t'i përgjigjen, me shkrim, çdo kërkesë me shkrim për sqarim për rendin e ditës, dërguar nga ortakët jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

14.4 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas formaliteteve të këtij neni dhe të nenit 83 ligjit dhe 16 të statutit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm, firmoset një listë prezence, dhe ata shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë së thirrjes.

Neni 15

Përfaqësimi në Asamble

15.1 Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Autorizimi duhet të përmbajë me saktësi delegimin konkret dhe kompetencat e dhena për mbledhjen konkrete dhe rendin konkret të ditës. Në rast të kundërt është i pavlefshëm dhe nuk mund të vazhdohet përfaqësimi deri sa të sigurohet përfaqësimi i vlefshëm me kompetencat e dhena shprehimisht. Përfaqësimi vec autorizimit mund të bëhet edhe me prokurë notoriale.

15.2 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

15.3 Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar. I përfaqësuarit nuk mund të heqë dorë nga vendimet e marra prej përfaqësuesit.

15.4 Në rast keq besimi, mund të kërkohet demshperblim në proporcion me demin e ardhur prej të përfaqësuarit ndaj përfaqësuesit. Kur nuk zgjidhet me mirekuptim demin, çështja i kalon gjykatës, sipas dispozitave të demit të parashikuara në Kodin Civil.

Neni 16
Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblesë

16.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal.

16.2 Administratori(et) është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

16.3 Procesverbali duhet të përmbajë të dhënat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të mbledhjes dhe të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qëndrimin e kryetarit për vendimmarrjen, si dhe të ortakeve, që janë shprehur kundër.

16.4 Procesverbalit i bashkëlidhen edhe liste prezenca e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

16.5 Procesverbali dhe liste prezenca e pjesëmarrësve duhet të nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 17
Quorumi, Votimi, Numerimi i Votave

17.1 Ne Asamblete e Përgjithshme quorumi llogaritet ne perputhje me Nenin 86 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

17.3 E drejta e votes qe u perket ortakeve eshte perpjestimore me kapitalin qe ata perfaqesojne.

Neni 18
Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve

Vendimet e miratuara ne Asamblene e Ortakeve do te kryhen ne perputhjen me Nenin 87 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" te ndryshuar

Neni 19
Administrimi i Shoqërisë dhe Kompetencat e Administratorit

19.1 Administrator i shoqerise eshte Andi Comi. Administratori zgjidhet per nje periudhe 1 (nje) vjecare, sipas Nenit 95 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar

19.2 Administratori ka keto te drejta dhe detyra:

a) të japë direktiva për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë.

b) të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;

c) të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, përthelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

d) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

e) Në mardhenie me të tretet, dhe Institucionet e Administratës publike, apo Gjyqësore ku perfaqëson shoqërinë, ai mund të autorizojë edhe një person tjetër për perfaqësimin sa me sipër.

19.3 Administratori mund të përfitojë edhe një rroge, dhe/ose bonus që lidhet me punën dhe konsistencën e tij në shërbim të shoqërisë. Kjo shumë përcaktohet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Menyra dhe masa e shpërblimit të Administratorit, fiksohet në aktin e emerimit.

19.4 Administratori vepron në çdo Rrethane në emer të shoqërisë. Veprimet e Administratorit kufizohen nga ato kompetenca, e ligji u jep shprehimisht Asamblesë së Ortakëve.

19.5 Aktet e Administratorit, e ngarkojnë shoqërinë teresisht me detyrim.

19.6 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet të tjera të mëposhtme:

- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
- hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, pas miratimit me shkrim nga ortakët;
- nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit, pas miratimit me shkrim nga ortakët;
- marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në çdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Ortakëve në lidhje me procedurat sa me sipër.

- ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyre tjetër aktive të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.

KREU IV VITI FINANCIAR - EKSPERTET - BILANCI

Neni 20 Viti Financiar dhe Dividendi

20.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor.

20.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave të nenit 77 të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.

Neni 21

Eksperti/Ekspertet Kontabel i autorizuar, emerimi, dhe shperblimi

21.1 Asambleja e pergjithshme e ortakëve, cakton kontrollor te pavarur nga lista e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

21.2 Ne caktimin e kontrolloreve te pavarur mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara nga ligji "Per shoqerite tregtare".

21.3 Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe ku pergjigjet nje ushtrim financiar. Ata jane te ricaktueshem. Shperblimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga Asambleja e Ortakëve dhe perballohet nga shoqeria.

Neni 22

Detyrat dhe te drejtat e ekspertit kontabel te autorizuar

22.1 Detyrat dhe te drejtat e eksperteve dhe kontrolloreve jane ato te parashikuara nga Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar .

22.2 Asambleja e ortakëve mund tu kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve dhe verifikimeve te posaçme per çeshtje ne interes te shoqerise. Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne Mbledhjen qe mbyll llogarite e vitit financiar te mbyllur, si dhe ne te gjitha Asamblete e Ortakëve.

22.3 Raportet qe ata pergatitin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

22.4 Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerine e tyre.

22.5 Ekspertet kontabel mbajne pergjegjesi per demet qe i shkaktojne shoqerise nga pasaktesia e mbajtjes se llogarive dhe nga verifikimi i gabuar i tyre.

22.6 Nuk mund te caktohen eksperte kontabel personat qe kane qene administratore, ose te punesuar ne kete shoqeri deri pese vjet nga koha e largimit te tyre nga kjo shoqeri.

22.7 Nje ose disa ortakë qe perfaqesojne 1/10 e kapitalit themeltar brenda 30 diteve nga dita e caktimit, mund te kundershtojne ne gjykate ekspertet kontabel te autorizuar te emeruar nga asambleja dhe te kerkojne nga asambleja emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, qe te ushtrojne funksionin ne vend te tyre.

Neni 23

Ushtrimi financiar.

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar te çdo viti dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin periudhen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri ne 31 Dhjetor.

Neni 24.

Inventari Llogarite vjetore.

24.1 Shoqeria mban nje kontabilitet te rregullt ne pajtim me ligjin. Ne mbyllje te cdo ushtrimi financiar.

24.2 Administratori harton inventarin e elementeve te ndryshem te aktivitetit dhe te pasivitetit ne kete date, si dhe llogarite vjetore te shoqerise.

24.3 Administratori harton raportin vjetor per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar te mbyllur, ndryshimet e ardhshme te parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis dates kur eshte hartuar raporti, dhe veprimet e kerkimit e te zhvillimit.

Neni 25.

Menyrat e pagimit te dividendeve. Paradheniet

25.1 Asambleja e zakonshme ka te drejte t'i jape cdo ortakut dividendet. Menyrat e pagimit te dividendeve ne para caktohen nga asambleja e sipas Nenit 13.

25.2 Pagimi i dividendeve ne para duhet te kryhet brenda nente muajve pas mbylljes te ushtrimit financiar, pervec ky afat zgjatet me vendim te gjykates.

25.3 Dividendi është pjesa që i takon secilit ortak nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.

25.4 Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga Ligji Nr.9228 Date, 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Neni 26

Rikthimi i Pagesave te Paligjshme

Ortakët detyrohen t'i kthejnë shoqërisë të gjitha shumat e përfituara nga ajo në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.

Këtu përfshihet dividendi, nëse ortakët kishin dijeni apo nuk kishin dijeni si të mos ishte në dijeni që dividendi apo përparësitë e tjera ishin marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji. Padia për rikthimin e përfitimeve, sipas këtij neni, parashkruhet brenda 3 vjetëve nga data e kryerjes së pagesës së parregullt.

Neni 27

Publikimet

Publikimet lidhur me sa me sipër kryen në përputhje me Ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Rregjistrimin e Biznesit", të ndryshuar.

Neni 28

Bilanci, Mbajtja e Llogarisë

28.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.

28.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.

28.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas Nenit 13 të këtij statuti.

KREU V

PRISHJA - RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 29

Prishja dhe likuidimi

29.1 Prishja e Shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i pareali-zueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve

29.2 Regjistrimi i Prishjes së Shoqërisë

Administratori/et janë të detyruar të regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës

Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Rregjistrimin e Biznesit", te ndryshuar.

29.3 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me ne perputhje me parashikimet e nenit 99 te Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ne perputhje me Nenin 13 pika 1 te ketij statuti.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërisve tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftesisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 30

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve me shumice te cilesuar ne perputhje me Nenin 13 pika 1 te ketij statuti, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).

Neni 31

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktajnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 32

Ndryshimet në Statut

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve me shumice te cilesuar prej 80% sikunder parashikohet ne neni 13 i ketij Statuti .

Neni 33

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Neni 34
Dispozitat përfundimtare




Ky Statut u redaktua në 5 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim nën për nen nga Ortakët e shoqërisë tregtare "Erseka Solar Park 2" sh.p.k, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale. Një kopje do të dorëzohet në QKB, nga një kopje për secilin ortak dhe një kopje do të mbahet si pjesë e dokumentacionit bazë të shoqërisë.

ORTAKËT
E SHOQËRISË
ERSEKA SOLAR PARK 2 sh.p.k

Shoqeria FAVINA sh.p.k

Administratoret




Viktor Qylafi Adnan Qylafi

Shoqeria FAVINA 1 sh.p.k

Administratoret

Viktor Qylafi Adnan Qylafi

Shoqeria M&K ENERGY TRADING CO sh.p.k

Administratori

Fatmir QYLAFI




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SHOQERIA FAVINA SH.P.K

VENDIM NR.131
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE
TË SHOQËRISE "FAVINA" SH.P.K

Sot me date, 12.12.2022 u mbledh Asambleja e ortakeve te shoqërisë FAVINA sh.p.k, me pjesmarrjen e ortakeve VIKTOR QYLAFI zoterues i 50 % të kuotave të kapitalit dhe ADNAN QYLAFI zoterues i 50% të kuotave të kapitalit, e cila ne mbeshtetje te Ligjit Nr.9901,datë 22.04.2008 "Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", i ndryshuar, ne VKM-ne Nr.399 date, 09.06.2022, VKM-ne Nr.400 date, 09.06.2022 dhe te akteve ligjore e nenligjore te fushes ne fuqi

VENDOSI

1. Shoqeria Favina sh.p.k, anetare e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive "M&K Energy Trading Co" sh.p.k, "Favina" sh.p.k dhe "Favina 1" sh.p.k te jete :

1.1 Ortak themelues me 24% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 1 e cila do te themelohet per projektin "Erseka Solar Park 1" .

1.2 Ortak themelues me 24% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 2 e cila do te themelohet per projektin "Erseka Solar Park 2" .

2.Te nenshkruhet nga shoqeria Favina sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k.

3.Te nenshkruhet nga shoqeria Favina sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .

4.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruhet per projektin "Erseka Solar Park 1" pas themelimit dhe regjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k .

5.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruhet per projektin "Erseka Solar Park 2" pas themelimit dhe regjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .



6.Me nenshkrimin nga ortaket te ketij Vendimi, Vendimi Nr.130 Date, 18.11.2022 i Asamblese se Ortakeve te shoqerise Favina sh.p.k, shfuqizohet .

SHOQERIA FAVINA sh.p.k

ORTAKET

Viktor QYLAFI

Adnan QYLAFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SHOQERIA FAVINA 1 SH.P.K

VENDIM NR.83
I ASAMBLESE SË ORTAKËVE
TË SHOQËRISE FAVINA 1 SH.P.K

Sot me date, 12.12.2022 u mbledh Asambleja e ortakeve te shoqërisë FAVINA 1 sh.p.k me pjesmarrjen e ortakeve VIKTOR QYLAFI me 50 % të kuotave të kapitalit dhe ADNAN QYLAFI me 50% të kuotave e cila ne mbeshtetje te Ligjit nr.9901, datë 22.04.2008 “Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, te ndryshuar, ne VKM-ne Nr.399 date, 09.06.2022, VKM-ne Nr.400 date, 09.06.2022 dhe te akteve ligjore e nenligjore te fushes ne fuqi

VENDOSI:

1. Shoqeria Favina 1 sh.p.k, anetare e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive “M&K Energy Trading Co” sh.p.k, “Favina” sh.p.k dhe “Favina 1” sh.p.k te jete :

1.1 Ortak themelues me 24% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 1 e cila do te themelohet per projektin “Erseka Solar Park 1” .

1.2 Ortak themelues me 24% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 2 e cila do te themelohet per projektin “Erseka Solar Park 2” .

2.Te nenshkruset nga shoqeria Favina 1 sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k.

3.Te nenshkruset nga shoqeria Favina 1 sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .

4.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruset per projektin “Erseka Solar Park 1” pas themelimit dhe rregjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k .

5.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruset per projektin “Erseka Solar Park 2” pas themelimit dhe rregjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .

6.Me nenshkrimin nga ortaket te ketij Vendimi, Vendimi Nr.76 Date, 18.11.2022 i Asamblese se Ortakeve te shoqerise Favina 1 sh.p.k shfuqizohet .

SHOQERIA FAVINA 1 SH.P.K

ORTAKET

Viktor QYLAFI



Adnan QYLAFI

VENDIM NR.24
I ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË
SHOQËRISË M & K ENERGY TRADING CO SH.P.K

Sot me date, 12.12.2022 u mbledh Asambleja e Ortakeve te shoqerisë M&K Energy Trading Co sh.p.k, person juridik me NIPT: M04516001I, me pjesmarrjen e ortakeve Viktor Qylafi zoterues i 51 % te kuotave te kapitalit, Fatmir Qylafi zoterues i 24.5 % të kuotave të kapitalit dhe Kristi Qylafi zoterues i 24.5 % të kuotave te kapitalit e cila ne mbeshetjete te Ligjit nr.9901, datë 22.04.2008 “Per Tregëtarët dhe Shoqeritë Tregëtare”, ne VKM-ne Nr.399 date, 09.06.2022, VKM-ne Nr.400 date, 09.06.2022 dhe te akteve ligjore e nenligjore te fushes ne fuqi

VENDOSI:

1. Shoqeria M&K Energy Trading Co sh.p.k sh.p.k, anetare e Bashkimit te Perkohshem te Shoqerive, “Favina” sh.p.k dhe “Favina 1” sh.p.k dhe M&K Energy Trading Co sh.p.k te jete :

1.1 Ortak themelues me 52% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 1 e cila do te themelohet per projektin “Erseka Solar Park 1” .

1.2 Ortak themelues me 52% te kuotave te kapitalit ne shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Erseka Solar Park 2 e cila do te themelohet per projektin “Erseka Solar Park 2” .

2.Te nenshkruhet nga shoqeria M&K Energy Trading Co sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k.

3.Te nenshkruhet nga shoqeria M&K Energy Trading Co sh.p.k Statuti i shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k, i hartuar dhe dakordesuar nga ortaket e shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .

4.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruhet per projektin “Erseka Solar Park 1” pas themelimit dhe rregjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 1 sh.p.k .

5.Te negociohet, lidhet dhe nenshkruhet per projektin “Erseka Solar Park 2” pas themelimit dhe rregjistrimit ne QKB te shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k Kontrata ndermjet Autoritetit Kontraktor, Ministrise te Infrastruktures dhe Energjise dhe shoqerise Erseka Solar Park 2 sh.p.k .

6.Me nenskrimin nga ortaket te ketij Vendimi, Vendimi Nr.23 Date, 18.11.2022 i Asamblese se Ortakeve te shoqerise M&K Energy Trading Co sh.p.k sh.p.k shfuqizohet .



SHOQERIA M&K ENERGY TRADING CO SH.P.K

ORTAKET

VIKTOR QYLAFI

FATMIR QYLAFI

KRISTI QYLAFI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 399, datë 9.6.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES
TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE "ERSEKA SOLAR
PARK 2" DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT
KONCESIONI, NË ZONËN E ERSEKËS, BASHKIA KOLONJË, QARKU
I KORÇËS, NGA BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE "FAVINA"
SH.P.K., "FAVINA 1", SH.P.K. DHE "M&K ENERGY TRADING CO",
SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "Erseka Solar Park 2" dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës, nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:
 - a) Emrin e aplikuesit: Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k.;
 - b) Numrin e identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS:
"FAVINA", sh.p.k. : J64104078V,
"FAVINA 1", sh.p.k. : K54624001I,
"M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k.: M04516001I;

- c) Tipin e centralit: Fotovoltaik;
- ç) Kapacitetin e instaluar: 20 MW;
- d) Afatin e pritshëm të vënies në punë: Koha për ndërtimin dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga marrja e lejes së ndërtimit;
- dh) Vendndodhjen e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës;
- e) Afatin e operimit: 49 (dyzet e nëntë) vite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) Koordinatat e tokës sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ose institucione të tjera të autorizuara kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.
- g) Bashkimit të përkohshëm të shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., i lind e drejta të krijojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit një shoqëri për qëllime të veçanta, për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik. Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., dhe shoqëria për qëllime të veçanta do të jenë bashkërisht përgjegjëse për detyrimet sipas këtij miratimi dhe kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
- gj) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike "Erseka Solar Park 2" dhe veprave ndihmëse, me kapacitet të instaluar 20 MW, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës, e dhënë sipas këtyre rregullave, si dhe më shumë se 10% e kuotave të shoqërisë për qëllime të veçanta mund të transferohet te një subjekt i tretë, tërësisht ose pjesërisht, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- h) Bashkimi i përkohshëm i shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., ose shoqëria për qëllime të veçanta ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ose institucioneve të tjera të autorizuara informacion mbi ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

- ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
- iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës ndërmjet bashkimit të përkohshëm të shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., ose shoqërisë për qëllime të veçanta dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj.;
- iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë, sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;
- v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimi i përkohshëm i shoqërive "FAVINA", sh.p.k., "FAVINA 1", sh.p.k., dhe "M&K ENERGY TRADING CO", sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

Sistemi koordinativ KRRGJSH, SIP.=32.16 Ha

Nr.	Veri	Lindje
1	4470415.52	559651.38
2	4470419.85	559704.17
3	4470456.22	559695.22
4	4470468.29	559732.13
5	4470495.14	559736.07
6	4470500.52	559727.29
7	4470500.36	560167.50
8	4470477.09	560177.14
9	4470466.88	560186.09
10	4469967.84	560186.09
11	4469970.28	560153.08
12	4469960.29	560132.46
13	4469952.90	560106.78
14	4469928.33	560078.94
15	4469896.11	560005.78
16	4469867.91	559973.86
17	4469883.49	559967.37
18	4469899.96	559967.26
19	4469931.68	559940.09
20	4469893.64	559853.17
21	4469868.15	559836.57
22	4469849.97	559774.64
23	4469814.11	559747.30
24	4469804.58	559703.38
25	4469779.03	559651.38

NR.PROT. 3336/1
DATË 10.6 - 2022

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE
"FAVINA", SH.P.K., "FAVINA 1", SH.P.K., "M & K
ENERGY TRADING CO", SH.P.K.
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm



Engjëll AGACI

Engjëll Agaci